



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

Departamenti për Monitorim

**Implementimi i Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve nga
Komunat e Kosovës**

Qershor 2008

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2. HYRJE.....	4
3. IMPLEMENTIMI I LIGJIT MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE.....	4
3.1 Informimi i publikut lidhur me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve	4
3.2 Rregulloret dhe praktikat komunale për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve që fliten tradicionalisht.....	4
3.3 Përdorimi i gjuhëve në raport me autoritetet komunale	5
3.4 Shërbyesit civil, ambienti i punës dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare.....	6
3.5 Përkthimet me gojë gjatë takimeve të përfaqësuesve dhe organeve ekzekutive.....	6
3.6 Përkthimet e dokumenteve zyrtare	6
3.7 Përkthimi i uebfaqeve komunale	7
3.8 Përdorimi i gjuhëve në shenja të rrugës dhe shenja të tjera topografike	7
3.9 Pengesat në zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve	8
3.10 Kapacitetet e përkthimit me shkrim dhe me gojë	8
4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	9

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nevojitet shumë më tepër se vetëm deklarata politike për të siguruar integrimin e komuniteteve joshqiptare në Kosovë. Veprimet politike të ndërmarra me qëllim të mbajtjes dhe riintegritimit të personave që u përkasin komuniteteve joshqiptare në kuadër të shërbimit civil të Kosovës nuk janë pasuar nga ndarja e burimeve të nevojshme për implementimin e ligjeve, siç është Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve¹ (në tekstin e mëtejshëm “Ligji për Gjuhët”), që ndikon në jetën e përditshme të personave që u përkasin komuniteteve joshumicë dhe mund të kontribuojë në integrimin ose ndarjen e tyre.

Nëntëmbëdhjetë muaj pas shpalljes, implementimi i Ligjit për Gjuhët mbetet problematik. Janë vërejtur disa rezultate pozitive përkthazi me shenjat topografike në të dy gjuhët zyrtare të vendosura në rrugët rajonale, ose sigurimi i përkthimit gjatë takimeve të organeve legjislative dhe ekzekutive komunale. Qeveria e Kosovës ka miratuar udhëzime administrative dhe ka themeluar Komisionin për Gjuhët.² Megjithatë, ende duhet të trajtohen disa sfida. Udhëzimet e rëndësishme administrative nuk janë publikuar apo nuk janë zbatuar në mënyrë të duhur, ndërsa publiku i përgjithshëm nuk ka qasje në to dhe nuk mund ta kërkojë zbatimin e tyre. Komunitetet gjuhësore nuk janë konsultuar apo përfshirë në emërimin e Komisionit për Gjuhët. Kufizimet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe mungesa e burimeve janë duke ndikuar në procesin e zbatimit negativisht dhe në Ligjin e pikërishtëm nuk identifikohen dhe ndahen mjete specifike për të përkrahur zhvillimin e kapaciteteve komunale adekuate. Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë të informimit publik, me qëllim të qartësimit të obligimeve të institucioneve qendrore dhe komunale, si dhe të drejtave të përdoruesve të gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve tjera të komuniteteve.

Kosova mbetet një shoqëri e ndarë në vija gjuhësore. Për gati njëzet vjet, fëmijët e komuniteteve shqiptare dhe serbe të Kosovës nuk janë arsimuar në të dy gjuhët zyrtare. Në shumicën e rasteve, ata vazhdojnë të arsimohen ndaras. Komunitetet shqiptare dhe serbe të Kosovës, gjithashtu, pranojnë kujdes mjekësor dhe shërbime komunale të ndara. Kjo ndarje gjithashtu ndikon tek komunitetet tjera, të cilat shpesh detyrohen të zgjedhin njërin prej dy sistemeve, apo të cilave autoritetet Kosovare duhet ende t’ua plotësojnë në tërësi të drejtat gjuhësore në arsim. Si rrjedhojë, këto gjenerata të reja njohin dhe flasin vetëm njërin prej gjuhëve zyrtare dhe nuk mund të komunikojnë ndërmjet tyre. Në të njëjtën kohë, këto gjenerata në të ardhmen do të jenë përgjegjëse për sigurimin e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare në qeveri dhe shoqëri civile. Ndërsa gjasat për një hapësirë të përbashkët shumëgjuhësore, shoqërore dhe institucionale po zvogëlohen, ky paradoks duhet të trajtohen me një përkushtim të qartë nga komunitetet e përfshira dhe me masa të politikave adekuate. Nëse dëshirohet të ruhet shoqëria shumëgjuhësore dhe sistemi institucional, atëherë duhet të trajtohen konflikti dhe shkaqet kryesore të tij.

Edhe nëse, si rezultat i zhvendosjes të lidhur me konfliktin, disa rajone dhe komuna të Kosovës së sotme e kanë humbur larminë e tyre shumëgjuhësore apo janë bërë më pak të larmishme, personat e zhvendosur ende mbajnë të drejtën e tyre për t’u kthyer, për të kërkuar dhe për të marrë informata mbi çështjet komunale, si dhe mund të kërkojnë shërbime nga këto autoritete. Komunitetet janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit, pavarësisht nga përbërja e tyre demografike.

¹ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, siç është shpallur me Rregullore të UNMIK-ut nr. 2006/5.

² Ky organ funksionon në bazë të nenit 32 të Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ të Zyrës së Kryeministrit nr. 2007/03 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 2007/06.

2. HYRJE

Përmes miratimit të Ligjit për Gjuhët, në tetor 2006, Kuvendi i Kosovës harmonizoi legjislacionin ekzistues mbi përdorimin e gjuhëve dhe riafirmoi përkushtimin për të siguruar përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare, gjuhës shqipe dhe serbe. Ligjvënësi gjithashtu përcaktoi kushtet përmes së cilave gjuhët e komuniteteve të tjera mund të njihen dhe përdoren në komunat, ku komuniteti i përfshirë gjuhësor përbën tre deri në pesë përqind të popullatës, apo ku gjuha e tyre flitet tradicionalisht. Duke u bazuar në nenin 2.3 dhe 2.4 të Ligjit, gjuhët që fliten tradicionalisht apo që fliten nga tre përqind e popullatës mund të njihen si “gjuhë në përdorim zyrtar”. Përdoruesit e gjuhëve të tilla mund të pranojnë shërbime dhe të marrin dokumente në gjuhët e tyre vetëm përmes kërkesave individuale. Përveç kësaj, gjuhët e folura nga pesë ose më shumë përqind e popullatës mund të njihen si gjuhë zyrtare shtesë e komunës. Përdoruesit e këtyre gjuhëve kanë të njëjtat të drejta si përdoruesit e gjuhës shqipe dhe serbe. Megjithatë, njohja e gjuhëve përmes pragjeve demografike do të zbatohet vetëm pas kryerjes së regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë. Ligji për gjuhët është një instrument i avancuar ligjor. Ai bazohet në Kornizën Kushtetuese dhe e plotëson atë³, Ligjin Kundër Diskriminimit⁴ dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Kosovë për mbrojtjen e pakicave kombëtare dhe gjuhët rajonale ose të pakicave.⁵

Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ka vlerësuar se si i kanë përmbushur komunat obligimet e tyre sipas Ligjit, në mënyrë që t’ia mundësojnë Qeverisë së Kosovës përmirësimin sistematik të veprimit në përputhje me rregulloret dhe të llogaridhënies ndaj komuniteteve gjuhësore. OSBE-ja ka analizuar praktikën, siç janë: përkthimi gjatë takimeve; përkthimi i dokumenteve zyrtare dhe uebfaqeve komunale; përdorimin e gjuhëve në shenjat zyrtare dhe topografike; kapacitetet e përkthimit me shkrim dhe të përkthimit me gojë dhe pengesat që ndikojnë në implementimin e Ligjit.

3. IMPLEMENTIMI I LIGJIT MBI PËRDORIMIN E GJUHËVE

3.1 Informimi i publikut lidhur me Ligjin mbi përdorimin e gjuhëve

Qeveria e Kosovës nuk e ka përmbushur obligimin e saj për “... të zhvilluar një program të vetëdijesimit të publikut sa i përket Ligjit, menjëherë pas shpalljes së tij,” siç kërkohet në nenin 36.2 të Ligjit. OSBE-ja ka vërejtur aktivitete të informimit publik vetëm në Klinë/Klina, ku komuna ka zhvilluar një takim konsultativ publik para miratimit të rregullores mbi përdorimin e gjuhëve, si dhe në Obiliq/Obilić, ku Zyra Komunale për Komunitete mblodhi përfaqësuesit e komuniteteve për të diskutuar rreth zbatimit të Ligjit për Gjuhët nga autoritetet komunale.

3.2 Rregulloret dhe praktikën komunale për njohjen dhe përdorimin e gjuhëve që fliten tradicionalisht

Sipas nenit 2.4 dhe 35 të Ligjit për Gjuhët, komunat ishin të obliguara të miratojnë rregullore të hollësishme lidhur me njohjen e gjuhëve që fliten tradicionalisht në territorin e tyre brenda gjashtë muajve nga data e shpalljes së tij. Në gusht 2007, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal miratoi Udhëzimin Administrativ nr. 2007/06, në të cilin parashtrihen procedurat përmes të cilave komunat do t’i njohin gjuhët në përdorim zyrtar, sipas kushteve të specifikuara nga Ligji për Gjuhët.

Siç është raportuar, njëzetedy (22) komuna kishin marrë Udhëzimin Administrativ, ndërsa njëmbëdhjetë (11) prej tyre nuk e kishin pranuar. Deri më tani, vetëm një komunë ka miratuar rregullore komunale mbi përdorimin e gjuhëve⁶, e cila nuk i përcakton procedurat përmes të cilave mund të njihen gjuhët e tjera nga komuna në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ. Disa komuna janë duke ndjekur procedura joformale. Në pesë komuna, gjuhët përveç asaj shqipe dhe serbe ishin në përdorim zyrtar që para shpalljes së Ligjit. Në pajtim me Ligjin, gjuha turke tani është gjuhë zyrtare në Prizren. Në 2007

³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kapitull 3 (Të drejtat e njeriut) dhe 4 (Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre).

⁴ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 2004/3, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32.

⁵ Ashtu siç rregullohet në Kornizën Kushtetuese, Kapitulli 3.2 (g); (h) dhe Kapitulli 3.3.

⁶ Komuna e Klinës/Klina, Rregullorja mbi përdorimin e gjuhëve në institucionet komunale nr. 01-07-72/07.

dhe 2008, Gjilani/Gnjilane, Mitrovica/Mitrovica, Prishtina/Priština dhe Vushtrria/Vučitrn kishin njohur gjuhën turke si gjuhë në përdorim zyrtar. Megjithatë, deri më këtë datë, janë ndarë burime të kufizuara apo nuk janë ndarë fare burime për ta mbështetur një përkushtim të tillë. Në Prizren dhe Dragash/Dragaš, legjislacioni komunal dhe shenjat në ndërtesat komunale janë gjithashtu në gjuhën boshnjake. Në Dragash/Dragaš dhe Pejë/Peć, emrat e rrugëve dhe shenjat topografike janë në gjuhën shqipe, serbe dhe boshnjake. Në vitin 2008, në Novobërdë/Novo Brdo është zbatuar një projekt për t'i përkthyer shenjat e rrugëve në të dy gjuhët zyrtare. Në disa komuna të tjera, personat gjuha e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare kanë mundësinë që t'i dorëzojnë parashtresat e tyre dhe të pranojnë përgjigje në gjuhët e tyre amtare, sipas dispozitave të Statuteve Komunale përkatëse apo si praktikë e krijuar.⁷ Ndonëse gjuha romë flitet tradicionalisht në Prizren dhe kualifikohet për njohje të tillë sipas nenit 2.4 të Ligjit, Komuna as nuk e njeh, e as nuk i mbron të drejtat gjuhësore të këtij komuniteti të konsiderueshëm.

3.3 Përdorimi i gjuhëve në raport me autoritetet komunale

Neni 7.2 i ligjit parasheh që “Çdo person ka të drejtë të komunikojë dhe të pranojë shërbimet e mundshme dhe dokumentet publike nga institucionet komunale dhe nga zyrtarët në cilëndo gjuhë zyrtare. Çdo organ përfaqësues dhe ekzekutiv komunal ka për detyrë të sigurojë se çdo person mund të komunikojë dhe të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal në cilëndo gjuhë zyrtare.” Neni 8.1, më tej, përcakton të drejtën e personave të cilët u takojnë komuniteteve, gjuha e të cilëve është në përdorim zyrtar, të paraqesin të gjitha kërkesat dhe dokumentet në formë të shkruar ose gojore, si dhe përgjigjet nga institucionet dhe nga zyrtarët komunalë t'i marrin në gjuhën e tyre, nëse ata kërkojnë kështu.

Në 17 komuna të ndryshme, OSBE-ja ka intervistuar persona që u takojnë komuniteteve joshumicë, të cilët kanë përshkruar përvojat pozitive dhe vështirësitë që ata/ato hasin gjatë përdorimit të gjuhës së tyre amtare në raport me autoritetet komunale. Me anë të anketës u hulumtua edhe çështja e perceptimit të sigurisë lidhur me lëvizjen dhe përdorimin e gjuhës amtare në vendet publike ku banon popullsia shumicë. Njëzetetë përqind e të intervistuarve kanë hasur në probleme gjatë pranimit të shërbimeve në gjuhët e tyre përkatëse. Këta i takonin komunitetit serb, turk, rom dhe boshnjak të Kosovës. Dyzet përqind e të intervistuarve kanë theksuar vështirësitë për të pranuar dokumente të shkruara në gjuhën e tyre. Këta i takonin komunitetit serb, turk, rom, boshnjak dhe kroat të Kosovës.

Folësit e gjuhës serbe i kanë nënvizuar vështirësitë në komunikimin me autoritetet komunale dhe në marrjen e shërbimeve dhe dokumenteve dhe theksuan faktin që zyrtarët e moshës më të re nuk e flasin gjuhën serbe. Përkundrazi, banorët shqiptarë të Kosovës të Komunës së përzier të Novobërdës/Novo Brdo janë përgjigjur se nuk kanë pasur vështirësi për të komunikuar dhe për të marrë shërbime dhe dokumente në gjuhën e tyre amtare. Të njëjtat perceptime pozitive u shprehën edhe nga pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe egjiptian me gjuhë amtare shqipe, të cilët jetojnë në Ferizaj/Uroševac, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Gjakovë/Đakovica.

Kroatët e Kosovës nga Lipjani/Lipljan dhe boshnjakët e Kosovës nga Dragashi/Dragaš, Prizreni dhe Peja/Peć i kanë nënvizuar vështirësitë që i referohen lëshimit të dokumenteve të shkruara në gjuhën e tyre, siç janë dokumentet e nevojshme për nxjerrjen e dokumenteve të identifikimit dhe certifikatave të vdekjes, raportet mjekësore dhe udhëzimet, si dhe njoftimet në stendat e afishimit të institucioneve të shëndetit primar, të cilat ofrohen vetëm në gjuhën shqipe. Folësit e gjuhës turke në Gjilan/Gnjilane dhe Prishtinë/Priština kanë pasur problem të komunikojnë me autoritetet komunale dhe të marrin shërbime dhe dokumente në gjuhën turke nga këto autoritete. Disa të intervistuar janë ndër të sfiduar kur kanë pranuar dokumente me shkrim të lëshuara nga autoritetet lokale, meqë shumica e dokumenteve ishin në gjuhën shqipe dhe ishte e vështirë të sigurohej përkthimi i tyre. Deri më tani, gjuha romë nuk gëzon mbrojtje apo përkrahje të veçantë në Kosovë. Ndonëse komuniteti rom tradicionalisht ka folur gjuhën e vet në komuna të ndryshme, ajo nuk është njohur dhe mbetet e kufizuar kryesisht në sferën private.

⁷ Dragash/Dragaš, Klinë/Klina, Deçan/Dečane, Shtërpçë/Štrpce, Kamenicë/Kamenica, Novobërdë/Novo Brdo, Prishtinë/Priština, Zvečan/Zveçan dhe Junik.

Folësit e gjuhës rome kanë probleme për të komunikuar me autoritetet komunale dhe për të marrë shërbime ose dokumente për faktin se zyrtarët komunalë nuk flasin gjuhën rome, prandaj, ata duhet të flasin në gjuhën shqipe ose në gjuhën serbe.

Të intervistuarit që flasin gjuhën serbe dhe rome kanë shprehur perceptime të pasigurisë lidhur me lirinë e lëvizjes së tyre dhe përdorimit të gjuhës amtare në vendet publike të banuar nga popullata shumicë e komunave të veçanta siç janë Gjilani/Gnjilane, Mitrovica/Mitrovica dhe Klina/Klina.

3.4 Shërbyesit civil, ambienti i punës dhe përdorimi i gjuhëve zyrtare

Ashtu siç kërkohet me nenin 7.5 të Ligjit, “Institucionet komunale duhet të sigurojnë që ambienti i tyre i punës të kontribuojë në përdorimin efektiv të gjuhëve zyrtare, si dhe të mundësojë përdorimin e cilësdo gjuhë zyrtare nga zyrtarët dhe punëtorët e tyre.”

Siç raportohet, nëntë komuna dhe pilot njësi komunale nuk kanë shërbim civil të përbërë nga shumë komunitete, ndërsa 24 komunat tjera dhe administrata në veri të Mitrovicës/Mitrovica kanë së paku nga një shërbyes civil që i përket një komuniteti joshumicë. Në 20 komuna, shërbyesit civilë thonë se ndjehen mirë me përdorimin e ndonjërës prej gjuhëve zyrtare gjatë kontakteve me kolegët e punës. Në një numër shumë të vogël të komunave, shërbyesit civilë që flasin serbisht nuk ndjeheshin mirë me përdorimin e gjuhës amtare gjatë kontakteve të tyre me grupe kolegësh (Klinë/Klina), apo nuk kanë mundur të komunikojnë drejtpërdrejtë në serbisht me zyrtarë komunalë, të cilët kanë kërkuar përkthyes si kusht për t’u takuar (Ferizaj/Uroševac). Për këta zyrtarë pohohej se ishin në gjendje por nuk dëshironin të flisnin në gjuhën serbe. Ndonëse kërkimi i përkthyesit nuk nënkupton mosveprim në përputhshmëri me Ligjin për Gjuhët, autoritetet relevante komunale mund të konsiderojnë marrjen e veprimeve për ta bërë ambientin e tyre të punës më të favorshëm mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare. Në 18 komuna, shërbyesit civil konfirmuan se punonjësit komunikojnë me publikun në cilëndo gjuhë zyrtare për arsye të ndryshme, për faktin se:

- janë të gatshëm t’i përdorin të dyja gjuhët, sipas nivelit të aftësisë së tyre të njohjes së gjuhës;
- dëshirojnë t’i përmbahen Ligjit;
- ka traditë institucionale të komunikimit në shumë gjuhë, e cila është mbajtur madje edhe gjatë periudhave më të tensionuara;
- zyrtarët e lartë japin shembull dhe komunikojnë me publikun në të dyja gjuhët zyrtare.

Sipas nenit 7.5, aty ku shërbyesit civil nuk janë të aftë për të komunikuar në një apo më shumë gjuhë zyrtare ose gjuhë në përdorim zyrtar, autoritetet komunale janë përgjegjëse për të siguruar përkthim të nevojshëm.

3.5 Përkthimet me gojë gjatë takimeve të përfaqësuesve dhe organeve ekzekutive

Sipas neneve 7.3 dhe 8.4 të Ligjit, komunat janë të obliguara që të sigurojnë përkthim nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën dhe nga njëra gjuhë zyrtare në gjuhën tjetër të komunitetit nëse ka kërkesë për një gjë të tillë. Ky obligim u referohet takimeve të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të kuvendit dhe takimeve publike të organizuara nga komuna.

Hulumtimi ka treguar se procedurat formale dhe joformale për kërkimin e përkthimit me gojë ekzistojnë vetëm në 18 komuna dhe pilot-njësi komunale. Me pak përjashtime, përkthimi me gojë në këto komuna kryesisht sigurohet pas kërkesës së parashtruar në organet e përfaqësuese dhe ato ekzekutive, si dhe grupet punuese komunale për kthimin.

3.6 Përkthimet e dokumenteve zyrtare

Siç kërkohet me nenin 7.4 të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve “shënimet e takimeve dhe shënimet zyrtare të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive komunale, regjistrat publikë dhe dokumentet e tjera zyrtare, mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës.” Përveç kësaj, neni 7.6 thekson se “[r]regulloret dhe aktet plotësuese të miratuara nga institucionet komunale nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës [...]”. Megjithatë, mbetet shumë për t’u bërë për të siguruar barazinë e

gjuhëve zyrtare. Mungesa e vullnetit dhe e resurseve vazhdon të mbizotërojë në disa komuna me shumicë shqiptare dhe në ato me shumicë serbe. Fakti që asnjë ose pak persona, gjuhë amtare e të cilëve është serbishtja ose shqipja, jetojnë ose janë kthyer në vendet e tyre të prejardhjes, duket të jetë arsyeja pse disa komuna nuk i përkthejnë dokumentet e tyre në njërin prej gjuhëve zyrtare.

Në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zveçan dhe Zubin Potok, procesverbalet e organeve përfaqësuese dhe atyre ekzekutive nuk lëshohen në gjuhën shqipe. Në komunat me shumicë shqiptare, procesverbalet në gjuhën serbe rrallëherë ose asnjëherë nuk janë në dispozicion në disa kuvende komunale, komitete për politika dhe financa, komitete për ndërmjetësim, borde të drejtorëve dhe, në masë më të vogël, në grupet punuese komunale për kthim. Ndarja e njëjtë në mes të komunave veriore me shumicë serbe dhe atyre jugore me shumicë shqiptare mbizotëron sa u përket përkthimeve të vendimeve dhe rregulloreve të Kuvendit Komunal; të konkluzioneve, propozimeve dhe rekomandimeve të komiteteve të kuvendeve komunale; dhe vendimeve të bordeve të drejtorëve dhe të departamenteve. Dokumente të tilla janë gjithmonë ose në shumicën e herëve në dispozicion në gjuhën shqipe në jug të Kosovës, por jo në veri të saj; dhe ato nuk publikohen apo botohen në serbisht në disa komuna me shqiptarë të Kosovës.

3.7 Përkthimi i uebfaqeve komunale

Neni 7.2 i Ligjit i detyron autoritetet komunale të “[...] sigurojnë se çdo person mund [...] të pranojë shërbimet në dispozicion dhe dokumentet publike nga çdo institucion dhe organ komunal në cilëndo gjuhë zyrtare,” ndërsa sipas nenit 7.6 “[r]eguloret dhe aktet plotësuese të miratuara nga institucionet komunale nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare të komunës.”

Uebfaqet komunale ofrojnë qasje në informatat elektronike mbi mandatet, aktivitetet, shërbimet dhe mundësitë e punësimit. Që nga nëntori i vitit 2007, 23 komuna dhe pilot-njësi komunale kanë hapur uebfaqe, prej të cilave 17 funksionojnë. Në adresat e këtyre uebfaqeve, emrat e komunave janë vendosur në shqip në 17 dhe në serbisht në 6 raste. Kjo pabarazi nuk është në pajtim me obligimin për të siguruar status të barabartë të të dyja gjuhëve zyrtare. Asnjë komunë nuk është në pajtueshmëri të plotë me obligimin për të siguruar përdorim të barabartë të të dyja gjuhëve zyrtare. Në katër uebfaqe nuk ishte asnjë dokument të përkthyer në gjuhën serbe, ndërsa në pesë uebfaqet e tjera numri i dokumenteve të përkthyer në gjuhën serbe asnjëherë nuk ishte më i lartë se 29% të totalit. Më shumë dokumente, por jo të gjitha (54-74%), janë përkthyer në serbisht në tetë uebfaqet e komunave të mbetura. Në dhjetë uebfaqe deri në 16% të dokumenteve vetëm pjesërisht ishin të përkthyer në gjuhën serbe.

Sa i përket cilësisë së përkthimit në gjuhën serbe, OSBE-ja ka vlerësuar se konvertimi i përmbajtjes ka qenë i saktë në nëntë uebfaqe dhe më se i mjaftueshëm në katër sosh. Cilësia është më e dobët për sa i përket gramatikës dhe sintaksës. Gabime serioze janë identifikuar sa i përket përdorimit të alfabetit serb, posaçërisht për shkak se shkronjat specifike të këtij alfabeti nuk janë përdorur apo janë zëvendësuar me simbole në shumicën e këtyre uebfaqeve. Si rrjedhojë, cilësia është vlerësuar si e pasaktë apo më pak se e mjaftueshme në shtatë uebfaqe, si dhe e mjaftueshme deri te e saktë në gjashtë të tjera.

3.8 Përdorimi i gjuhëve në shenja të rrugës ose shenja të tjera topografike

Sipas nenit 9.2 të ligjit: “Shenjat zyrtare që shënojnë apo përfshijnë emrat e komunave, fshatrave, rrugëve, rrugicave dhe të vendeve të tjera publike, paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët e të cilat kanë statusin e gjuhës zyrtare në komunë, në pajtueshmëri me nenin 2.3” Në pajtim me nenin 11.2(k) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30, kuvendet komunale kanë përgjegjësi ekskluzive për marrjen e vendimeve lidhur me “[e]mërtimin dhe riemërtimin e rrugicave, rrugëve dhe vendeve të tjera publike.”

Vetëm 20 nga 34⁸ njësi administrative kanë miratuar vendime ose rregullore mbi emërtimet e rrugëve. Në 17 sosh, vendimet e kuvendit komunal mbulojnë emërtimet e të gjitha apo shumicën e rrugëve dhe vendeve publike vetëm në njërin prej gjuhëve zyrtare, varësisht prej komunitetit që përbën shumicën.

⁸ Përfshirë pilot-njësitë komunale dhe Administratën e përkohshme të OKB-së në Mitrovicë/Mitrovica

Peja/Peć dhe Dragashi/Dragaš janë komunat e vetme në të cilat të gjithë emrat e rrugëve janë përkthyer dhe ekspozuar si në shqip ashtu edhe në serbisht, siç kërkohet me nenin 9.2 të Ligjit.

Shumica e rrugëve (78%) janë emërtuar sipas personaliteteve dhe në shumicën e vendimeve, emrat e përveçëm të përzgjedhur janë shqiptarë apo serbë. Përzgjedhja e emrave të personaliteteve që i përkasin ekskluzivisht ose pothuajse ekskluzivisht komunitetit shumicë parandalon përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare dhe ka efekt diskriminues. Problemi do të mund të trajtohej duke këmbëngulur te komunat që të përdorin emra të përgjithshëm të cilët do të mund të përktheheshin në të gjitha gjuhët zyrtare pa pengesë, duke siguruar kështu pajtueshmëri me nenin 9.2 të Ligjit.

Përveç kësaj, neni 9.2 i Ligjit parasheh që në territorin e çdo komune shenjat zyrtare që tregojnë ose përfshijnë emrat e komunave dhe të fshatrave do të paraqiten në gjuhët zyrtare të komunës. Ministria është përgjegjëse për mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit në rrugët magjistrale dhe rajonale, ndërsa komunat janë përgjegjëse për shenjat e komunikacionit në rrugët lokale. Ministria e Transportit dhe Komunikacionit ka siguruar instalimin e shenjave dygjuhësore në rrugët rajonale në tërë territorin e Kosovës. Në 16 komuna, OSBE-ja ka vërejtur se në këto shenja në vazhdimësi paraqiten emrat zyrtarë të komunave dhe të fshatrave në të dy gjuhët zyrtare. Në 17 komuna dhe pilot-njësi komunale janë vërejtur shkelje. Në këto shkelje hyjnë përdorimi i emërtimeve jozyrtare,⁹ emërtimet e vendeve vetëm në një gjuhë zyrtare, gabime drejtshkrimore në emërtimet zyrtare, shenja të dëmtuara të cilat nuk janë pastruar apo zëvendësuar, dhe disa shenja topografike që janë hequr apo shkatërruar.

3.9 Pengesat në zbatimin e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve

OSBE-ja ka identifikuar disa pengesa që negativisht prekin zbatimin e Ligjit, të pranishme këto në më shumë se gjysmën e komunave: mungesa ose numër i pamjaftueshëm i punonjësve të njëjësive të përkthimit dhe pamundësia për të punësuar asistentë të rinj gjuhësorë; paga të ulëta – të pamjaftueshme për të joshur ose mbajtur asistentë më të kualifikuar gjuhësorë; asistentët gjuhësorë janë të mbingarkuar me punë; komuna ndanë dhe/ose ka burime të pamjaftueshme financiare, mungesa e politikave (me shkrim) mbi përdorimin e gjuhëve. Pengesa të tjera janë konsideruar si të rëndësishme për më pak se 50% të komunave: mungesa e motivimit të asistentëve gjuhësorë, për shkak të kushteve të punës, mbingarkesa e lartë e punës, ose faktorë tjerë që ndikojnë në gjendjen morale; dokumentet nga institucionet qendrore janë vetëm në gjuhën shqipe; asistentët gjuhësorë përdoren për detyra të tjera; komuna nuk është e përkushtuar në politikën e gjuhëve; punonjësve gjuhësorë ka përvojë të pamjaftueshme profesionale. Praktika e institucioneve të ndryshme qendrore, e dërgimit të dokumenteve zyrtare te autoritetet komunale vetëm në gjuhën shqipe, ose dorëzimi i dokumenteve zyrtare të përkthyer dobët në serbisht, janë nënvizuar si arsye shqetësuese në 11 komuna.

3.10 Kapacitetet e përkthimit me shkrim dhe me gojë

Ndonëse Ligji mbi përdorimin e gjuhëve nuk e parasheh këtë në mënyrë eksplicite, zbatimi i ligjit kërkon resurse njerëzore, financiare dhe teknike adekuate, të cilat shpeshherë janë të pamjaftueshme. Këtu përfshihet krijimi i njëjësive të përkthimit, angazhimi i një numri adekuat të asistentëve të kualifikuar gjuhësorë, dhe sigurimi i kushteve të duhura të punës dhe mundësitë për zhvillim profesional.

Nga 34 njësi administrative, 28 sosh kanë themeluar njësi të përkthimit dhe 24 komuna kanë caktuar personat kontaktues për çështje gjuhësore. Gjashtë komuna nuk kanë fare asistentë gjuhësorë, 23 tjera kanë një deri në dy asistentë gjuhësorë dhe vetëm pesë kanë punësuar tre apo më shumë asistentë. Nga 56 asistentë gjuhësorë që punojnë nëpër komuna, 48 ofrojnë shërbime në shqip dhe serbisht (1.4 për një komunë). Nuk ka pasur punësime të reja në vitin 2008. Prandaj, mungesa apo numri i pamjaftueshëm i punonjësve ndikon në efikasitetin e shërbimeve të përkthimit me shkrim/me gojë apo shkakton dështime

⁹ Drenas/Gllgovac në vend të Gllgoc/Glogovac dhe Skenderaj/Skenderaj në vend të Skenderaj/Srbica janë përdorur në rrugët rajonale dhe lokale. Në Obiliq/Obilić disa shenja rrugore në rrugën rajonale Prishtinë/Priština – Mitrovicë/Mitrovica përdorin emrin “Kastriot” në vend të Obiliq.

të shpeshta në përkthimin e dokumenteve të punës të organeve përfaqësuese ose ekzekutive. Asnjë njësi e përkthimit nuk ka angazhuar lektorë gjuhësorë përgjegjës për lektorim dhe kontroll të cilësisë. Meqë dokumentet përgatiten në gjuhën burimore shqipe në shumicën e komunave, kjo në veçanti ndikon në cilësinë e përkthimeve në serbisht. E njëjta gjë vlen edhe për gjuhën shqipe në komunat me shumicë serbe.

Pajisjet funksionale për përkthim simultan janë instaluar dhe përdoren në 20 komuna. Në shtatë komuna tjera, pajisjet nuk funksionojnë apo nuk përdoren, ndërsa në gjashtë komuna nuk ka fare pajisjet për përkthim simultan.

Njësitë e përkthimit nuk kanë buxhet të veçantë dhe në disa raste nuk kanë pajisje adekuate apo hapësirë për zyra. Sipas vëzhgimit të OSBE-së, 22 komuna nuk kanë ndarë mjete të mjaftueshme financiare për të shtuar kapacitetet e tyre. Nuk ka në dispozicion plan-program të specializuar të arsimit të lartë në Kosovë për trajnimin dhe certifikimin e specialistëve të përkthimit me shkrim dhe me gojë, juristëve gjuhësorë dhe përkthyesve gjyqësorë. 31 nga 56 asistentë gjuhësorë të angazhuar nga komunat, kanë të kryer vetëm shkollën e mesme. Në dhjetë komuna asnjë asistent i intervistuar nuk ka thënë se ka ndjekur kurs të specializuar. 25 asistentë kanë deklaruar se kanë ndjekur vetëm një seancë trajnimi apo kurs të organizuar nga Instituti Kosovar i Administratës Publike, Ministria e Shërbimeve Publike dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në periudhën kohore prej 2005 deri 2007. Këto kurse ishin të shkurtër, me kohëzgjatje prej një deri në pesë ditë. Shtatë asistentë i janë nënshtruar trajnimit plotësues të specializuar nga institucionet e tjera.

Në vitin 2007, Njësia qendrore për monitorim gjuhësor pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike ka filluar sistematizimin e aktiviteteve me synim të vlerësimit të nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe dizajnimin të trajnimeve të zhvillimit profesional për njësitë gjuhësore të Ministrive. Çdo tre muaj punonjësit e këtyre njësive i nënshtrohet një testit të aftësive gjuhësore rezultatet e të cilit përdoren për të identifikuar dobësitë dhe për të dizajnuar kurse për ngritje të kapaciteteve. Në vitin 2007, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Instituti Kosovar i Administratës Publike, kanë organizuar bashkërisht një trajnim mbi teknikat e përkthimit, për të gjithë asistentët gjuhësorë në nivel qendror dhe shumicën e asistentëve gjuhësorë në nivel komunal.

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nëntëmbëdhjetë muaj pas shpalljes së Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve janë ndarë resurse të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për zbatimin e këtij Ligji në nivel komunal. Duhet të miratohen rregullore komunale mbi njohjen dhe përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve në përdorim zyrtar shtesë. Komuna të ndryshme vazhdojnë të pranojnë nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore dokumente të papërkthyer në serbisht ose me përkthime të cilësisë së dobët, por nuk i raportojnë këto raste në Komisionin për Gjuhët.

OSBE-ja mirëpret krijimin e Komisionit për Gjuhët në maj të vitit 2007, si mekanizëm qendror për mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit të ligjit, si dhe lëshimin e disa udhëzimeve administrative, por vëren se disa prej tyre nuk janë publikuar¹⁰ ose nuk janë zbatuar në mënyrë adekuate. Prandaj, opinioni publik nuk ka qasje në to dhe nuk mund të kërkojë zbatimin e tyre. Një vit pas themelimit të Komisionit për Gjuhët, opinioni publik përgjithësisht nuk është në dijeni për këtë dhe rëndësinë e përdorimit të procedurave që kanë të bëjnë me gjuhët. Në Komision është parashtruar vetëm një ankesë. Emërimi dhe përbërja e Komisionit nuk kanë mundur pjesëmarrjen dhe përfaqësimin efektiv të të gjitha komuniteteve gjuhësore, siç kërkohet me nenin 32.10 të Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve. Për më tepër, Komisioni nuk ka buxhet vetanak, resurse dhe hapësirë për zyrë. Ministrinë dhe Kuvendi i Kosovës nuk e kanë ftuar Komisionin që të komentojë për projektligjin që ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve.

¹⁰ Për shembull Udhëzimi Administrativ i Zyrës së Kryeministrit nr. 2007/03 dhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 2007/06.

Për shkak të këtyre arsyeve, OSBE-ja rekomandon që institucionet e Kosovës të:

- **Zhvillojnë** një fushatë të vetëdijesimit publik, të publikojnë të gjitha udhëzimet relevante administrative dhe të ndajnë resurse financiare, njerëzore dhe teknike adekuate për të siguruar zbatimin e ligjit;
- **Sigurojnë** që komunat të miratojnë rregullore mbi gjuhët, të rregullojnë funksionimin e njësive të përkthimit dhe të hartojnë plan-programin për zhvillim profesional sistematik për njësitë e përkthimit;
- **Ndryshojnë** përbërjen e Komisionit për Gjuhët për të mundësuar pjesëmarrjen dhe përfaqësimin efektiv të të gjitha komuniteteve gjuhësore dhe të fuqizojnë Komisionin që të veprojë në mënyrë efektive dhe të pavarur përmes resurseve adekuate dhe përkrahjes logjistike;
- **Sigurojnë** që sistemi arsimor i Kosovës të mos fuqizojë ndarjen gjuhësore dhe të sigurojë mësimdhënie të plotë në cilëndo gjuhë zyrtare të zgjedhur me lëndë të obligueshme, si dhe të sigurojnë trajnime të rregullta për shërbyesit civilë për të mundësuar mësimin e të dyja gjuhëve zyrtare.